



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 19.07.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 17.07.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Basri Sopjani" për aktivitetin: "Furnizimi me pelet" me Nr. të Prok: 616 19 091 111 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Basri Sopjani" "e datës 17.07.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me pelet" me Nr. të Prok: 616 19 091 111 kundër njoftimit të vendimit të AK –së, të datës 15.07.2019 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë aktivitetin sipas publikimit të datës 15.07.2019 .

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Besri Sopjani" me datë 17.07.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ' "Furnizimi me pelet" me Nr. të Prok: 616 19 091 111 .

Autoriteti Kontraktues, me datë 19.07.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Lidhur me pretendimin se ju keni plotësuar kërkesat ne realizimin e kontratave te ngjajshme ne tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimi te njoftimit në vlerën minimale prej

130,000.00€ iu sqarojme se kerkesa e Autoritetit Kontraktues ka qene si vijon:

OE-ik duhet te ofroj dëshmi te mjaftueshme se ka realizuar kontrata te ngjashme ne tri vitet e fundit,duke filluar nga data e publikimi te njoftimit në vlerën minimale prej 130,000.00

Ndërsa ju ne Aneksin 6 keni paraqitur dy kontrata ne vlerat prej 29,025.61€ dhe 6,191.00€ dhe keni paraqitur datat e perfundimit te tyre jane k 20.06.2019 dhe 01.06.2019 qe do te thotë se jane kontrata qe jane perfunduar pas datës te publikimit për ketë aktivitet .Pasi qe këto dy referenca nuk mund te pranohen rrjedh se vlera totale e referencave tuaja te pranueshme eshte 105,105.15€, dhe me kete vlere nuk e plotësoni kërkesën e Autoritete Kontaktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës ,
- Departamentit të prokurimit; dhe
- Njësisë së kërkesës.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit